

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6644
E premte, 1 korrik 2022
çmimi 0.40

Po, PDK-ja është
parti politike e krijuar
nga UÇK-ja! | FAQE 6

Nga: Ramiz
LLADROVCI



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI MBAJTI SEANCË PËR NGRITJEN E ÇMIMEVE NË VEND | FAQE 4-5

OPOZITA E KRITIKON QEVERINË PËR MOSVEPRIM PAS SHTRENJTIMIT TË PRODHIMEVE



Deputetë të partive opozitare e kanë kritikuar kryeministrin Albin Kurti se nuk është duke marrë asnjë veprim sa i përket ngritjes së çmimeve për prodhimet esenciale në vend. Sipas opozitës, sot qytetarët po përballen me ngritje të madhe të çmimeve. Lideri i Lidhjes Demokratike

të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka kërkuar nga qeveria të ndër marrë masa për uljen e këtyre çmimeve. Adresim të njëjtë për këtë situatë patën edhe përfaqësuesit e PDK-së dhe të AAK-së, të cilët dhanë edhe propozime për ta lehtësuar krizën ekonomike në vend



**LAJÇAKU:
VENDIMI I
KOSOVËS
NDRYSHOI
TEMAT, NUK
DUHET TË
LEJOJMË TË
KETË KRIZË**

| FAQE 7



**AAK-ja I JEP PËRKRAHJE
PROCESIT TË VETINGUT** | FAQE 6

AKTUALE



**PAPA FRANÇESKU AKUZON RUSINË
PËR AGRESION DHE IMPERIALIZËM
NË UKRAINË** | F. 2

**TË NGRIHET AKCIZA E NAFTËS PËR
TRE MUAJ DHE TË SHKURTOHET
TVSH-JA PËR PRODHIMET BAZË**

F. 5

**KONSTITUOHET GRUPI I MIOËSISË
KOSOVË - GJERMANI** | F. 7



EKONOMI



**MUNGESA E PUNËTORËVE FUT
KOSOVËN NË KRIZË** | F. 8

SPORT



**LAURA FAZLIU DHE AKIL GJAKOVA IA
SJELLIN KOSOVËS EDHE DY MEDALJE**

F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Papa Françesku akuzon Rusinë për agresion dhe imperializëm në Ukrainë

VATIKAN, 30 QERSHOR - Papa Françesku akuzoi të enjten Rusinë se po kryen një fushatë "pushtimi të armatosur, ekspansionizmi dhe imperializmi" në Ukrainë, duke e quajtur konfliktin "një luftë mizore dhe të pakuptimtë agresioni". Duke folur me delegacionin ortodoks me bazë në Patriarkatin Ekumenik të Stambollit, Papa Françesku tha se konflikti ka vendosur të krishterët kundër njëri-tjetrit. Si Rusia ashtu edhe Ukraina janë me popullsi të krishterë ortodoksë, por ka një pakicë katolike me ndikim bizantin në Ukrainë besnike ndaj papës. Degët lindore dhe perëndimore të krishterimit u ndanë në përçarjen e madhe të vitit 1054. "Pajtimi midis të krishterëve të ndarë, si një mjet për të kontribuar në paqen midis popujve në konflikt, është e një rëndësie të veçantë këto ditë, pasi bota jonë është e përfshirë

nga një luftë mizore dhe e pakuptimtë agresioni në të cilën shumë e shumë të krishterë po luftojnë njëri-tjetrin", ka thënë Papa. Papa i tha vizitorëve të tij ortodoksë, duke iu referuar Ruisë, se të gjithë duhet të jenë të vetëdijshëm se pushtimi i armatosur, ekspansionizmi dhe imperializmi nuk kanë të bëjnë me mbretërinë që Jezusi shpalli në tokë". Kjo ishte dita e dytë radhazi që papa foli për konfliktin në Ukrainë. Të mërkurën ai dënoi bombardimin e një qendre tregtare në qytetin e Kremençukut, duke e quajtur atë "sulmin e fundit barbar ndaj Ukrainës". Lufta në Ukrainë ka shkaktuar ndasi të mëdha në botën Ortodokse. Patriarku i Kishës Ortodokse Ruse, Kirill, ka dhënë bekimin e tij të plotë ndaj pushtimit të Moskës në Ukrainë, që nga nisja e konfliktit më 24 shkurt.



Pozicioni i tij ka lëkundur Kishën Ortodokse në mbarë botën dhe ka shkaktuar një rebelim të brendshëm që ka çuar në ndërprerjen e lidhjeve të disa kishave ortodokse lokale dikur të lidhura me Kishën Ortodokse Ruse.

Presidenti rus Vladimir Putin, i ka përshkruar veprimet e Moskës në Ukrainë si një "operacion special ushtarak" që synon çmilitarizimin dhe "denazifikimin" e vendit. Papa e ka hedhur poshtë një terminologji të tillë.

Në një intervistë të publikuar muajin që shkoi, Papa Françesku tha se Patriarku rus Kirill "nuk mund të shndërrohet në djalin e altarit të Putinit". Më pas, Kisha Ortodokse Ruse kritikoi papën mbi komentet e bëra. Papa Françesku do të takohet me Kirill më 14 qershor në Jerusalem por plani u anulua në prill pas këshillimit me diplomatët në Vatikan. Kjo do të kishte qenë hera e dytë që dy kërret e Kishave të krishtere do të takoheshin. Në takimin e tyre të parë, në Kubë, në vitin 2016 ishte hera e parë që një papë dhe një lider i Kishës Ortodokse Ruse takoheshin. Më herët gjatë këtij muaji, Britania e Madhe sanksionoi Kirill mbi "mbështetjen e tij të zëshme ndaj agresionit ushtarak të Ruisë në Ukrainë". Në anën tjetër Hungaria bllokoi tentativën e BE-së për ta sanksionuar atë.

Ukraina shkëput lidhjet diplomatike me Sirinë



KIEV, 30 QERSHOR - Ukraina ka shkëputur lidhjet diplomatike me Sirinë, pasi Damasku ka njohur pavarësinë e rajoneve lindore ukrainase, Donjeck dhe Luhansk. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky, ka bërë të ditur këtë vendim përmes një postimi në Telegram. "Nuk do të ketë më marrëdhënie në mes të Ukrainës dhe Sirisë", ka thënë Zelensky, duke thënë se presioni me sanksione kundër Sirisë, "do të jetë edhe më i madh". Donjecku dhe Luhansku që njihen së bashku si Donbas janë duke u përballur me luftime të

ashpra, si pasojë e luftës që ka nisur Moska kundër Ukrainës, pak pasi ka njohur pavarësinë e këtyre dy rajoneve. Disa pjesë të Luhanskut dhe Donjeckut, janë nën kontrollin e separatistëve të mbështetur nga Moska, prej kur Rusia ka aneksuar Gadishullin ukrainas të Krimesë më 2014. Leonid Pasechnik, lider i separatistëve në Luhansk, ka falënderuar Sirinë dhe presidentin sirian, Bashar al-Asad, për atë që e ka konsideruar "gjest politik të përgjegjshëm dhe të guximshëm" për njohje të

Luhanskut si shtet sovran dhe të pavarur, ka raportuar agjencia ruse e lajmeve TASS. Siria, aleate e ngushtë e Ruisë, ka përfituar ndihmë ushtarake ruse në luftën e saj civile, është shteti i parë, pas Ruisë, që njeh pavarësinë e këtyre dy rajoneve separatiste. Siria ka qenë edhe në të kaluarën në anën e Ruisë. Më 2018, është pajtuar për të njohur Abhazinë dhe Osetinë, rajone të shkëputura gjeorgjiane, si shtete të pavarura. Ky hap ka nxitur Gjeorgjinë që të shkëpusë marrëdhëniet me Sirinë.

Johnson: S'do të lejojmë që Ballkani të bëhet shesh lojërash për Putinin

LONDËR, 30 QERSHOR - Britania e Madhe do të dërgojë ekspertë ushtarakë në Bosnje-Hercegovinë për të kundërshtuar ndikimin rus si dhe "për të forcuar misionin e NATO-s, dhe për të promovuar stabilitetin dhe sigurinë", ka njoftuar qeveria britanike të enjten. "Ne nuk mund të lejojmë që Ballkani Perëndimor të bëhet një tjetër shesh i lojërave për synimet shkatërruese të [presidentit rus, Vladimir] Putin", thuhet në deklaratën e kryeministrit britanik, Boris Johnson. "Duke ndezur flakët e secesionizmit dhe sektarizmit,

Rusia përpiqet t'i kthejë mbrapsht sukseset e tri dekadave të fundit në Bosnje-Hercegovinë", shtoi ai. Andaj, tha Johnson, kjo është arsyeja që "ne po forcojmë mbështetjen për Bosnje-Hercegovinën". "Ne po i përgjigjemi thirrjes së miqve tanë për të ndihmuar në mbrojtjen e paqes", tha ai. Sipas njoftimit të Qeverisë britanike, dy ekspertë për luftën kundër dezinformimit dhe reformën e mbrojtjes, do të punojnë me Forcat e Armatosura të Bosnje-Hercegovinës dhe NATO-n, për

të ruajtur paqen dhe sigurinë në këtë vend. Britania do të sigurojë, po ashtu, fonde për rritjen e sigurisë kibernetike atje. "Bosnje dhe Hercegovina aktualisht po përballen me kërcënimin më të madh ekzistencial prej pas luftës dhe liderët secesionistë po punojnë në mënyrë aktive për të krijuar ndarje dhe konflikte të mëtejme. Këto plane mbështeten nga Moska", thuhet në deklaratën e qeverisë britanike. Shqetësimet e Perëndimit për Bosnje-Hercegovinën janë rritur qëkur Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt.



Po, PDK-ja është parti politike e krijuar nga UÇK-ja!



Nga: Ramiz LLADROVCI

Disa të vërteta, për një pjesë të qytetarëve të Republikës së Kosovës, por edhe jashtë, lidhur me shtetin tonë dhe të arriturat, duken të pabesueshme. Disa të vërteta lidhur me Kosovën fillojnë me ecurinë e çlirimit, krijimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, aksionet e para kundër okupatorit serb, me logjistikën e UÇK-së kundër një superfuqie evropiane, me komandën dhe organizimin, por edhe me forcën e pakufishme morale të çlirimtarëve.

Kam moral të flas, për disa të vërteta, si njëri nga ata të parët, para se t'i dalim me armë në dorë, dolëm me propagandë, me libra, gazeta kundër regjimit, me ide, mobilizim, anëtarësim, zgjerim dhe përgatitje për luftë çlirimtare. Po ashtu, flas edhe si një nga themeluesit e Partisë Demokratike të Kosovës.

Kushdo që do ta harroj historinë e lavdishme të çlirimit të Kosovës, duhet ta dijë mirë se viti 1998 ishte vit që filloi të punonte ora e lirisë për ne. Dua të theksoj se ishin fillim vitet e '80-ta që demonstratat e fuqishme e trandën diktaturën. Kjo orë e lirisë që kishte filluar të punonte për ne, nuk ishte një shkrepje ideje e një çasti apo momenti e një njeriu, ishte një generatë që e përjetonte më rëndë se të parët tanë, peshën e robërisë.

Ishte akumuluar mllefi i tre e katër brezave që okupimin e Serbisë dhe Jugosllavisë që e paguante shtrenjtë synimin për liri - me jetë, me torturë, me burgje, me përndjekje, izolim, helmim e deri në zhdukje të individëve, familjeve e lagjeve të tëra, që nga reforma agrare e Krlevinës, deri në kohën e kriminelit Millosheviq.

Popullit shqiptar në ish Jugosllavi, nuk i kishte mbetur rrugë tjetër, pos lufta çlirimtare. Ne nuk kishim rrugë tjetër. Diplomacia e asaj kohe ishte e paaftë të ndalonte tanket serbe në fshatrat e Drenicës, partitë e atëhershme politike, nuk e fillonin luftën për shkak të rrugës dhe bindjes së tyre politike, bashkësia ndërkombëtare ishte e verbër

përball vuajtjeve tona.

Ne nuk kishim rrugë tjetër për liri, veç fillimin e luftës çlirimtare. Ne kishim zgjedhur vdekjen para se robërinë. Po, për disa sot, vërtetë duket e pabesueshme, ashtu siç kanë filluar edhe të tallen me të arriturën më madhështore të kombit tonë, pas Skënderbeut dhe Pavarësisë së Shqipërisë, shpalljen e Kosovës shtet të pavarur e sovran.

Komandanti legjendar i UÇK-së, Adem Jashari, ishte i destinuar nga historia për t'i pri luftës çlirimtare. Familja emblematike Jashari, ishte personifikim i një kombi pas së cilës u rreshtuan bijat e bijtë më të devotshëm të kombit, deri në sakrificë, si Fehmiu, Xheva, Ilazi, Abeja, Bedriu e mijëra dëshmorë që me vetëdije të plotë dhe vullnet të palëkundur ranë në fushën e nderit për liri dhe u çliruam. Nuk do harruar as përpjekjet atdhetare ndër breza, por, fati ishte te gjenerata jonë, për të qenë edhe dëshmitar të çlirimit, të fitores historike, të themelimit të partive politike dhe shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

Në të drejtën tonë, na ndihmoi NATO me në krye Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtet demokratike. Ideali shekullor u realizua. Liria fitoi kundër robërisë.

Kushdo që ka dilema se si u krijua Partia Demokratike e Kosovës, mund të gjej dokumentet e themelimit, por, edhe paralajmërimet e para pasi Kosova u çlirua. Paralajmërimi i parë u dha edhe në media, në "Kohën ditore", të datës 4 shtator 1999.

Kushdo që nuk beson se UÇK-ja me aleatët nuk e çliroi Kosovën, është i mashtruar. Kushdo që mendon se PDK-ja u krijua nga të pakënaqurit me partitë e atëhershme politike, gabohet rëndë.

Partia Demokratike u krijua nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, pasi Hashim Thaçi, drejtori i Drejtorisë Politike të UÇK-së dhe Shefi i Delegacionit tonë në Rambuje, u kthye nga vizitapane në tri qendrat e mëdha evropiane dhe diskutimi me partnerët tanë evropian.

Kryeqytetet vendimmarrëse të asaj kohe, Paris-Romë-Bonn ishte vendqëndrimi i z. Thaçi në fund të verës së nxehtë 1999 e fillim shtatori, dhe deklaroi se UÇK-ja do të transformohet në parti politike. Kjo ndodhi. Sot, vërtetë për disa është e pabesueshme çlirimi i Kosovës, ashtu siç ju duket e paktë kjo liri për të padijshmit, oportunistët, shantazhuesit, sabotatorët e UÇK-së dhe bashkëpunëtorët e ish regjimit vrastar.

Nuk do mend se ka komandant të UÇK-së apo veteranë të cilët

ndodhen në partitë tjera, sepse, jo i gjithë kontingjenti më kontribuues për çlirim është ekskluzivisht në PDK, ata ndodhen edhe në partitë tjera, por, transformimin e formacionit ushtarak nga UÇK në parti politike e mori Hashim Thaçi dhe u krijua PDK.

Për këdo që ka dilema se si u

krijua PDK dhe çfarë lidhje ka UÇK me PDK-në, pavarësisht qëndrimeve tona sot, po ua paraqes artikullin e "Kohës ditore", të datës 4 shtator 1999, për ngjarjet e 3 shtatorit 1999. Ne jemi këtu, dëshmitar të flasim edhe për UÇK edhe për PDK, pavarësisht bindjeve të opozitës apo ndonjë të

shkalluari kundër UÇK-së dhe transformimin e saj në PDK.

Kushdo provon ta njollosë UÇK-në, dëshmon karakterin e vet, njollos veten, origjinën, të kaluarën dhe synimet e veta të sëmura. Kushdo që e vë në dilemë krijimin e PDK-së nga UÇK-ja, gabon rëndë dhe po hyn në mal pa sakicë!

Hashim Thaçi në takim me liderë evropianë...

Paris-Romë-Bonn, aksi që po e çon transformimin e UÇK-së në parti politike

- Hashim Thaçi në takim me funksionarë të lartë francezë ka deklaruar se është dakord me të gjitha objektivat e komunitetit ndërkombëtar dhe do të japë kontributin e tij në bashkëpunim me KFOR-in dhe UNMIK-un...
- "Ministri (Richard) u kushtoi rëndësi të posaçme premtimeve të UÇK-së për përmbushjen e të gjitha obligimeve", u tha në deklaratën e lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes...

ILDA MIRA

PARIS, 3 SHTATOR - Lideri i shqiptarëve të Kosovës, Hashim Thaçi, gjatë qëndrimit të tij në Paris, premti se do të çarmatoset Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe se do t'i përmbushë obligimet e tij sipas marrëveshjes paqësore të Kosovës, thanë zyrtarët francezë të premtën.

Zedhënesi i Ministrisë së Jashtme të Francës, Francois Rivasseau, u tha gazetarëve se Thaçi ka premtuar se do ta shndërrojë UÇK-në në parti politike që do të kandidohet në zgjedhje të lira dhe se do të bashkëpunojë me paqeruajtësit e KFOR-it dhe me administratën e OKB-së. KFOR-i kohët e fundit është përballur me krime dhe sulme ndër më të ndryshmet, sidomos me sulme hakmarrëse të shiptarëve kundër serbëve. Konfrontime direkte midis shqiptarëve dhe paqeruajtësve ka pasur në Mitrovicë, ku banorët e këtij qyteti akuzuan KFOR-in francez për lëshimet që u bën serbëve.

Ministria e Mbrojtjes tha se Ministri francez i Mbrojtjes, Alain Richard, dhe Thaçi kanë diskutuar përmbushjen e obligimeve nga UÇK-ja — përfshirë ndihmën në krijimin e një shoqërie multietnike dhe çarmatosjen e saj — gjatë takimit të tyre që zgjati 45 minuta.


"Ministri (Richard) u kushtoi rëndësi të posaçme premtimeve të UÇK-së për përmbushjen e të gjitha obligimeve", u tha në deklaratën e lëshuar nga Ministria e Mbrojtjes...

Thaçi, i cili aktualisht gjendet në një turne nëpër shtete evropiane, vazhdoi udhëtimin e tij në Romë. Ai tha në Londër se është i perkushtuar në përpjekjet e tij për krijimin e një "shoqërie të tolerancës" në Kosovë dhe se demilitarizimi i UÇK-së do të përfundojë sipas planit.

UÇK-ja, që ka luftuar kundër Ushtrisë jugosllave, policisë serbe dhe njësitëve paraushtarakë, pritet të demobilizohet në tërësi deri, më 19 shtator.

Zoti Hashim Thaçi është pritur në Paris dhe nga drejtori i punëve politike në Ministrinë e Jashtme franceze Gerhard Herrera. Kjo vizitë e z. Thaçi është zhvilluar nën një frymë konstruktive të bashkëpunimit midis dirigjentëve kosovarë dhe atyre të shtetit francez.

Kjo vizitë e z. Hashim Thaçi mund të konsiderohet si një vazhdim i bised-



imeve të vizitës së fundit të tij, më 27 maj në Paris, në të cilën palët në takim nuk kanë rënë dakord që UÇK-ja të dorëzojë armët. Ndërsa në këtë takim të fundit përfundimet kanë qenë të kënaqshme për të dyja palët.

Sot, në mëngjes Hashim Thaçi është pritur nga ministri francez i Mbrojtjes Alain Richard, me të cilin ka diskutuar për bashkëpunimin që ky lider kosovar u ofron dy misionëve të OKB-së në Kosovë: Urmik dhe KFOR.

Hashim Thaçi u ka premtuar zyrtarëve të lartë francezë se ai do të ndihmojë në përfundimin e fazës së demilitarizimit të UÇK-së dhe transformimin e kësaj viziteje në një forcë politike.

Forcë me të cilën ai do të paraqitet përballë kandidatit tjetër kosovar, Ibrahim Rugova, për zgjedhjet e ardhshme në Kosovë. Sipas zedhënesit të ministrit të Jashtëm francez, Hashim Thaçi sot pasditë do të udhë-

toje me avion për në Romë, ku do të ketë dhe një takim me qeveritarë italianë dhe nesër ai pritet të kryejë një vizitë në Bonn.

Sipas zedhënesit të ministrit të Jashtëm francez, Franca është e vendosur për të mbajtur një marrëdhënie të ngushtë me të gjithë liderët kosovarë dhe për të bashkëpunuar me ta. Kjo vizitë e Hashim Thaçit, ka qenë pozitive për faktin se lideri i UÇK-së ka pranuar të gjitha objektivat e paraqitura nga komuniteti ndërkombëtar.

Te pyetur në një konferencë shtypi në Ministrinë e Jashtme se me çfarë titulli është pritur ky lider kosovar, si kryeministër i Qeverisë së përkosshme të Kosovës apo si lider i UÇK-së, zedhënesi i Ministrisë së Punëve të Jashtme është përgjigjur se në pritje të Hashim Thaçit dhe si anëtar i Këshillit konsultativ të Kosovës.



KUVENDI MBAJTI SEANCË PËR NGRITJEN E ÇMIMEVE NË VEND

Opozita e kritikon qeverinë për mosveprim pas shtrenjtimit të prodhimeve

Deputetë të partive opozitare e kanë kritikuar kryeministrin Albin Kurti se nuk është duke marrë asnjë veprim sa i përket ngritjes së çmimeve për prodhimet esenciale në vend. Sipas opozitës, sot qytetarët po përballen me ngritje të madhe të çmimeve. Lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka kërkuar nga qeveria të ndërmarrë masa për uljen e këtyre çmimeve. Adresim të njëjtë për këtë situatë patën edhe përfaqësuesit e PDK-së dhe të AAK-së, të cilët dhanë edhe propozime për ta lehtësuar krizën ekonomike në vend

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Me ftesë të opozitës, Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Kuvendi i Kosovës ka mbajtur të enjten seancë, në të cilën është diskutuar për ngritjen e çmimeve në vend.

Deputetët e opozitës kanë drejtuar akuza në drejtim të qeverisë se nuk po merr asnjë masë për t'i ulur çmimet për prodhimet esenciale.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, i është drejtuar kabinetit qeveritar se çështja e ngritjes së çmimeve nuk lidhet

më atë se çfarë bën Putini në luftën në Ukrainë, por se çfarë bën Albini në Kosovë.

Abdixhiku, duke debatuar lidhur me rritjen e çmimeve, ka pohuar se inflacioni në Kosovë ka arritur në 13 për qind. "Ju nuk keni zhvillim ekonomik. Pra, Kosova nuk ka zhvillim ekonomik dhe nuk jeni në gjendje të merrni asnjë masë. Inflacioni në Kosovë është 13 për qind, më i larti ndonjëherë. Ku këta po thonë se ky nuk vjen prej Albinut, por prej luftës së nisur prej Putinit. Çështja nuk është se çfarë bën Putini, por çfarë bën Albini, pra a e lejon që kjo krizë të vijë neto në Kosovë, apo ta zbus atë, prandaj ne

kemi punë me Albinin e jo me Putinin", ka thënë Abdixhiku. Sipas tij, qytetarët janë në kufi të mbijetesës. "Problemi im është për ata njerëz që janë në kufi të mbijetesës, që përballen çdo ditë me ngritjen e çmimeve. Teksa promovoni rritje të hyrave, prej kujt po i merrni ato, prej njerëzve tanë. Ju keni inat me propozuesin, e jo me propozimin. Ky është inati juaj, Albin. Kur ishe në vendin tim edhe ti e ke dhënë këtë propozim. Kjo është propozuar edhe nga ShBA-ja, Gjermania, Britania dhe shumë vende të tjera", ka deklaruar lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku.

Shefi i grupit parlamentar i

PDK-së, Abelard Tahiri, ka thënë se janë të vetëdijshëm sesi ka ardhur situata deri te ngritja e çmimeve dhe për këtë nuk e fajësojnë qeverinë, por atë e fajësojnë për mungesë të veprimeve për ta trajtuar këtë krizë. "Opozita para se të kritikojë ka ofruar edhe alternativë. PDK-ja e ka sjellë projektligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar, ku kemi propozuar që TVSh-ja në produktet esenciale ushqimore të zbritet nga 18 në 8 për qind. Sot mendojmë që TVSh-ja për produktet esenciale ushqimore duhet të hiqet krejtësisht për gjashtë muajt e ardhshëm", ka thënë Tahiri.

Tahiri ka thënë se qeveria "duhet ta rishikojë dhe vlerësojë drejt çështjen e akcizës në naftë". Ai ka thënë se Kosova në pesëmuajorin e parë të vitit 2021 ka importuar 287 milionë litra naftë dhe ka paguar taksa prej 32 milionë eurosh, kurse në pesëmuajorin e vitit 2022 (janar-maj) ka importuar 263 milionë litra naftë dhe ka paguar taksa

prej 54 milionë eurosh. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka propozuar gjashtë hapa të menjëhershëm që, sipas tyre, duhet të ndërmerren nga Qeveria e Kosovës.

Propozimin e bëri deputeti i kësaj partie, Pal Lekaj, i cili pati një mal kritikash për vizionin e qeverisë Kurti për rritjen e çmimeve. "Propozimet e AAK-së janë si në vijim: Për një periudhë tremujore të hiqen taksat për artikujt esenciale. Për tre muaj të përgjysmohen taksat e shitjes së karburanteve. Të rridraftohet ligji për pagën minimale ku shuma të ngrehet nga 250 në 350 euro dhe në këtë ligj të përfshihen edhe veteranët. Kuvendi para se të shkojë në pushim ta miratojë Ligjin e Pagave dhe të fillojë zbatimin. Të miratohet Projektligji për Tërheqjen e Trustit dhe të rishikohen kontratat për kryerje të punimeve që janë lidhur në vitin 2019-2020-2021 dhe ta harmonizojë me rritjen e

Të ngrihet akciza e naftës për tre muaj dhe të shkurtohet TVSh-ja për prodhimet bazë

PRISHTINË, 30 QERSHOR (ER) - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu, ka thënë se situata ekonomike në Kosovë çdo ditë e më shumë është duke u rënduar. Sipas tij, është duke vazhduar dominimi i agjendës politike qoftë sa i përket dialogut, lobimit, por edhe pjesëmarrjes në konferenca të ndryshme ndërkombëtare të përfaqësuesve institucionalë. “Është koha kur kjo situatë duhet të trajtohet me seriozitet më të madh nga ana

institucionale dhe të mos shndërrohet durimi qytetar në eksperiment. Besoj se është koha që me urgjencë të merret një vendim që të ngrihet apo pezullohet akciza në derivate të naftës për një periudhë të caktuar tremujore dhe të rishikohet ulja e TVSh-së për produktet bazike. Në Kosovë po shohim se po rritet varfëria, po rritet pakënaqësia. Kosova po zbrazet edhe më tepër. Dhe ky është një dëm shumë i madh për Kosovën dhe ardhmërinë saj. Besoj se është koha kur

institucionet e Kosovës të marrin vendim dhe të shikojnë drejt ardhmërisë. Sot ka shumë ankesa për mosmbështetje për rritje të prodhimit por, në anën tjetër, askush nuk gjen modalitet se si ta mbështesim bujqësinë dhe prodhimin”, ka thënë ai.

Gërxhaliu ka theksuar se nafta është e njëjtë si për amvisëri, biznese dhe sektorë të tjerë. “Besoj se është momenti dhe koha që të mos dëgjohen ‘matrapazët e ndryshëm ekonomikë’ duke kundërshtuar

idetë për ngrirjen e akcizës për një kohë të caktuar. Duhet të kuptohet se me akcizë rritet buxheti i Kosovës, por në raste të caktuara duhet të merren vendime që do të ndihmojnë qytetarët e Kosovës për të përfituar nga një vendim i tillë për shkak se nafta sjell efekte zinxhirore te rritja e çmimeve dhe nevojave për qytetarë. Nga akciza rriten të hyrat buxhetore dhe fitojnë tregtarët”, është shprehur ai.

Gërxhaliu ka thënë se sot inflacioni është mbi 13 për qind

dhe paraqet rrezikun më të madh social dhe ekonomik. “Projektet dhe investimet kapitale janë reduktuar në mënyrë ekstreme, e cila e godet sektorin privat. Ju lutemi veproni në këtë drejtim duke pezulluar akcizën për një kohë të caktuar dhe reduktuar TVSh-në në produkte esenciale në interes të qytetarëve dhe ardhmërisë ekonomike të Republikës së Kosovës. E di se nesër do të veproni, por kam frikë se do të jetë vonë!”, ka theksuar Gërxhaliu.



çmimeve”, ka thënë Lekaj. Në këtë seancë LV-ja ka propozuar miratimin e projektligjit për caktimin e marzhës së fitimit për produktet bazë. Ndërsa LDK-ja ka propozuar reduktimin e akcizës dhe TVSh-së në derivate për një periudhë tremujore me mundësi vazhdimi për tre muaj, si dhe zgjerimin e listës së produkteve me TVSh të shkurtuar.

Kurti: Është evidente se kemi rritje të çmimeve, po marrim masat e nevojshme

Ndërkaq kryeministri Albin Kurti ka thënë se është evidente se ka rritje të çmimeve në përgjithësi, e posaçërisht të

atyre për produktet e konsumit. “Më lejoni të them se Kosova nuk është e vetme në këtë situatë të rritjes së çmimeve. Çmimet janë rritur globalisht edhe për shkak të kufizimeve në zinxhirin e furnizimit. Pra, kryesisht kemi të bëjmë me inflacion të importuar, mbi të cilin ne si qeveri nuk është se kemi ndonjë mënyrë kontrolli apo ndikimi. Si qeveri kemi bërë maksimumin, që të sigurohem se po i marrim masat e nevojshme për t'i arritur tri qëllime kryesore: E para, t'i parandalojmë presionet inflacionare të brendshme aq sa mundemi; e dyta, t'i mbështetim ata që kanë më së shumti nevojë; dhe, e treta, të marrim masa kundër tregtarëve spekulantë, që tentojnë të shfrytëzojnë këtë

krizë për t'i trashur fitimet e tyre”, ka thënë Kurti, duke shtuar se për çmimin e karburanteve kanë marrë vendim për kufizim të marzhës së fitimit, dhe tani çmimet janë stabilizuar. “Krahasuar me rajonin, nafta te ne është për 23 centë më lirë sesa në Shqipëri, ndërsa 9 centë më shtrenjtë sesa në Maqedoninë e Veriut. Kurse benzina është 23 centë më lirë sesa në Shqipëri dhe 2 centë më lirë sesa në Maqedoninë e Veriut. Gjithashtu, është emëruar Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, i cili e ka mbështetjen e plotë të qeverisë për të luftuar çfarëdo veprimi që shkon në dëm të konkurrencës apo kurdije dhe spekulim të çmimeve në kurriz të qytetarëve”, ka thënë Kurti.



AAK-ja i jep përkrahje procesit të vetingut

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Lidhur me procesin e vetingut në drejtësi, kryeministri Albin Kurti është takuar me Selim Selimin nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Në takim të përbashkët me ministrin e Drejtësisë, Albulena Haxhiu dhe zëvendësministren Nita Shala, kryeministri Kurti përhapat e mëtejme lidhur me këtë proces dhe rëndësinë e koordinimit të përbashkët pas opinionit të pranuar nga Komisioni i Venecias. Partia e Ramush Haradinajt i ka dhënë përkrahje procesit të vetingut. "Në takim me kryeministrin Kurti për vetingun, Aleanca është përfaqësuar nga ish-ministri i Drejtësisë, Selim Selimi. Aty u paraqit qëndrimi ynë se AAK-ja këtë proces e konsideron të rëndësishëm dhe i jep përkrahje. Sidoqoftë, AAK-ja nuk ka besim që procesi të ketë sukses pa konsensus të plotë të brendshëm politik, pa përfshirjen e KGJK-së dhe KPK-së, pa mbështetjen e ShBA-së

dhe BE-së dhe pa përfilljen në përpikëri të qëndrimeve të Komisionit të Venedikut", është bërë me dije në njoftimin e AAK-së.

Me qëllim të përfshirjes së të gjithë aktorëve, Kurti u ka bërë ftesë krerëve të partive parlamentare të opozitës: Partisë Demokratike të Kosovës, Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Kurti një ditë më parë është takuar edhe me kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi. Ndërsa nga Lidhja Demokratike e Kosovës kanë deklaruar se kontributin e tyre për këtë çështje do të japin në Kuvendin e Kosovës.

Qeveria ka njoftuar se takime të këtilla me qëllim të koordinimit të mëtejme do të vazhdojnë edhe me partitë politike të komuniteteve të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Qeveria e Kosovës ka miratuar konceptdokumentin për zhvillimin e procesit të vetingut në sistemin e drejtësisë si dhe ka përgatitur draftin e amendamenteve



kushtetuese dhe projektligjin për vetingun në sistemin e drejtësisë.

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij procesi, respektimin e standardeve

evropiane, si dhe të drejtat e njeriut, Ministria e Drejtësisë kishte dërguar kërkesë në Komisionin e Venecias me qëllim të dhënies së opinionit për konceptdokumentin për

vetingun në sistemin e drejtësisë dhe draftin e amendamenteve kushtetuese. Më 17 qershor 2022 Komisioni i Venecias ka miratuar opinionin për vetingun.

Kurti zotohet për thellimin e bashkëpunimit me organizatën gjermane të arsimit



PRISHTINË, 30 QERSHOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur të enjten në takim kryetaren e organizatës gjermane të arsimit, Education Unlimited e. V, Kerstin Zielosko, me bashkëpunëtorë.

Kryeministri ka falënderuar përfaqësuesen gjermane të arsimit për bashkëpunimin e deritashëm, njëkohësisht ka shprehur gatishmërinë e thellimit për realizimin e projekteve të përbashkëta.

Kurti ndau me të pranishmit të arriturat kryesore gjatë qeverisjes, duke veçuar miratimin në lexim të parë të ligjit për rritjen e pagës minimale pas 11 vjetësh në 264 euro dhe lirin nga tatimi i të ardhurave deri në pagën minimale, si dëshmi e angazhimit serioz të qeverisë për përmirësimin e zotimeve para qytetarëve dhe ngritjen e mirëqenies së qytetarëve. Në mesin e planeve dhe

synimeve të qeverisë, kryeministri ka potencuar ngritjen e cilësisë së arsimit dhe urëzimin e tij me kërkesat e tregut të punës nëpërmjet modelit të sistemit dual të arsimit.

Në këtë drejtim u diskutua edhe për rëndësinë e edukimit në fëmijërinë e hershme dhe mundësinë e prezantimit të lëndës për kodim në shkollën e mesme dhe atë fillor.

Kryeministri Kurti theksoi edhe rolin shumë të rëndësishëm të diasporës në ndërtimin dhe thellimin e marrëdhënieve bilaterale me vendet ku ata jetojnë, por edhe në shkëmbimin e përvojave dhe dijes praktike.

Në shtator të vitit të kaluar, në Zyrën e Kryeministrit, u nënshkrua memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet qeverisë dhe Education Unlimited e. V për projekte arsimore.

Vendet e BE-së i pranojnë certifikatat e Covidit që i lëshon Kosova

PRISHTINË, 30 QERSHOR (ER) - Bashkimi Evropian (BE) tani e tutje do t'i pranojë certifikatat e vaksinimit dhe testeve të Covid-19 që lëshohen nga autoritetet e Republikës së Kosovës. Zyra e Bashkimit Evropian (BE) në Prishtinë ka

njoftuar se e njëjta vlen për të gjitha certifikatat e lëshuara nga Kosova e që janë në përputhje me rregulloren e BE-së. "Nga sot BE-ja do të fillojë t'i pranojë certifikatat e vaksinimit, testit dhe shërimit të Covid-19 të

lëshuara nga Kosova. Kjo vlen për të gjitha certifikatat e lëshuara në përputhje me rregulloren e BE-së 2021/953 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit. BE-ja ka financuar zhvillimin e tyre", ka njoftuar Zyra e BE-së në Kosovë.



Lajçaku: Vendimi i Kosovës ndryshoi temat, nuk duhet ta lejojmë të ketë krizë

PRISHTINË, 30 QERSHOR (ER) - Emisari special i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka deklaruar se vendimi i Kosovës për reciprocitet për letërnjoftimet "ka ndryshuar temat dhe planet e vizitës së tij". Ndërsa ka bërë thirrje që të mos tensionohet situata dhe të punohet drejt normalizimit të marrëdhënieve. "Unë erdha në rajon për t'u përgatitur për takimin e radhës të liderëve dhe për të folur për përparimin dhe normalizimin e marrëdhënieve. Tani duhet ta zgjidhim këtë situatë. Nuk duhet të lejojmë që të ndodhë ndonjë krizë", tha ai.

I pyetur për kërcënimet e presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ai nuk ka pranuar t'i komentojë kërcënimet. "Kemi pasur diskutim shumë serioz mbrëmë për situatën dhe sigurisht duhet të shikojmë për zgjidhje nëpërmjet dialogut dhe jokonfrontimeve", ka thënë Lajçak para medieve në Beograd.

Qeveria e Kosovës, në

mbledhjen 85-të, e zhvilluar në mënyrë elektronike, ka miratuar vendimin për të mundësuar regjistrimin e automjeteve me targa "RKS" për të gjitha automjetet e pajisura me targat "PR", "KM", "PZ", "GL", "UR", "PE", "DA" apo "DA", si dhe vendimin për kalimin e kufirit shtetëror nga qytetarët me dokumente personale të lëshuara nga autoritetet e Serbisë.

"Pronarëve të automjeteve të pajisura me targa të lartcekura u është mundësuar që nga 10 qershori i vitit 1999 deri më datën 21 prill 2022 regjistrimi i mjeteve me targa RKS". Sipas këtij vendimi, regjistrimi do të fillojë në fillim të gushtit dhe do të zgjasë deri më 31 shtator. Para vizitës në Beograd, Lajçaku ishte në Prishtinë. Ai të mërkurën shprehu optimizëm për takim në mes të krerëve të Kosovës dhe të Serbisë para pushimeve të verës.

Deri më tash Kurti dhe Vuçiqi janë takuar vetëm dy herë, por pa bërë ndonjë përparim konkret në dialogun për



normalizimin e marrëdhënieve.

Ky proces ka nisur qysh në vitin 2011, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian dhe mbështetjen e Shteteve të Bashkuara.

Duke reaguar ndaj vendimeve të Qeverisë së Kosovës më 29 qershor, Vuçiqi ka thënë se përgjigja e Serbisë do të jetë e matur. "Ne nuk do të ndërmarrim veprime ushtarake, por kërkojmë që të

mos ua marrin pronat njerëzve dhe të mos i dëbojnë", ka thënë ai.

Vuçiq, po ashtu, ka thënë se Serbia është e gatshme për dialog por, sipas tij, pala kosovare nuk është.

Konstituohet Grupi i Miqësisë Kosovë - Gjermani

PRISHTINË, 30 QERSHOR (ER) - Të enjten është bërë konstituimi i Grupit të Miqësisë Kosovë - Gjermani, i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku i pranishëm ishte edhe ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde.

Deputeti Elmi Reçica ka thënë se ky Grup i Miqësisë me Gjermaninë është i veçantë duke qenë se bëhet fjalë për një shtet në të cilin mërgata jonë jeton dhe vepron për dekada me radhë. "Bëhet fjalë për rreth 400 000 shqiptarë të Kosovës që me mundin dhe djersën e tyre, përveç që kanë mbajtur familjet e tyre në Kosovë, në të njëjtën kohë kanë kontribuar në çlirimin, shtetndërtimin dhe zhvillimin e atdheut të tyre, Kosovës. Me këtë rast, falënderova ambasadorin për rolin dhe kontributin e vazhdueshëm dhe të vlefshëm të Republikës



Federale të Gjermanisë në etablimin e Kosovës në planin ndërkombëtar, ku deputetët

gjermanë kanë një rol të rëndësishëm edhe në Parlamentin evropian, por

edhe në zhvillimin shumëdimensional të Kosovës përbrenda", ka thënë

Reçica.

Ai ka vlerësuar bashkëpunimin bilateral në të gjitha fushat, që nga ekonomia deri te siguria. "Në të njëjtën kohë, në kuadër të zhvillimeve të reja ndërkombëtare, agresioni ushtarak i Rusisë kundër një shteti të pavarur, Ukrainës, shtrova nevojën për shtimin dhe dinamizimin e mbështetjes së shtetit gjerman në procesin e integriteteve euroatlantike, veçanërisht anëtarësimin të Republikës së Kosovës në Këshillin e Evropës si dhe përafrimin në NATO përmes Programit të Partneritetit për Paqe, si dhe angazhimin e shtetit gjerman për njohjen e pesë shteteve të Bashkimit Evropian të cilat ende nuk e kanë njohur shtetin e Kosovës", ka thënë deputeti Reçica.

149 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 30 QERSHOR (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka bërë me dije se në 24 orët e fundit në Kosovë janë regjistruar 149 raste të reja me Covid-19 dhe asnjë rast i vdekjes. Sipas njoftimit, në 24 orët e

fundit janë shëruar 43 pacientë nga virusi Covid-19, ndërsa janë vaksinuar 57 persona.

Aktualisht numri i rasteve aktive me Covid-19 në Kosovë është 592.

Deri më tani numri total i

vaksinave të administruara është 1 milion e 830 mijë e 590 doza, ku 903 mijë e 439 janë me dozën e parë të vaksinës, 823 mijë e 740 me dozën e dytë dhe 103 mijë e 221 me dozën e tretë.



Mungesa e punëtorëve fut Kosovën në krizë



PRISHTINË, 30 QERSHOR - Orar i stërzgjatur i punës, mohim i pushimit vjetor, punë pa kontratë, pagë e ulët e me vonesa - janë ankesat që, ndër vite, kanë shprehur punëtorët të sektorit privat në Kosovë. Shumë prej tyre janë raportuar shpesh edhe në Inspektoratin e Punës, por nga Sindikata e Punonjësve e Sektorit Privat thonë se ato kanë kaluar pa u përfillur.

Kryetari Jusuf Azemi thotë se, për pasojë, Kosova ka arritur në një gjendje të vështirë ekonomike: me biznese që ankohen se nuk gjejnë punëtorë dhe me të papunë që s'duan të punojnë. "Punëtorë e të rinj të shumtë në Kosovë po ikin jashtë vendit... Nuk duan të jetojnë më me shpresën se do të bëhet mirë. Nuk duan të punojnë në kushte jo të mira të punës e me paga të ulëta", thotë Azemi. Gjatë vitit 2021 Inspektorati i Punës ka pranuar mbi 5 000 ankesa nga palë që kanë konsideruar se u janë shkelur të drejtat në vendin e punës. Të dhënat e tij për vitin e kaluar tregojnë, po ashtu, se nëntë qytetarë kanë humbur jetën në vendin e punës, 40 kanë marrë lëndime të rënda dhe 139 lëndime të lehta.

Zyrtarë të këtij institucioni kanë thënë se duhen përmirësuar kushtet e punës - në të kundërtën, punëtorët do të ikin.

Më 12 qershor "Radio Evropa e Lirë" ka sjellë rrëfimin e Imer Durakut, një fermer nga fshati Krushë e Madhe, i cili kultivon

kultura të ndryshme bujqësore, por ka problem me gjetjen e punëtorëve sezonalë. Pagesa që ofron është 20 euro në ditë, ose deri në 420 euro në muaj.

Shumë përdorues të rrjeteve sociale, që kanë komentuar rrëfimin e tij, thonë se nuk do të punonin për kaq para.

REL ka kontaktuar disa dhe njëri prej tyre, i cili ka kërkuar të mbetet anonim, thotë se deri para 4-5 vjetësh ka punuar si elektrikist në një kompani private në Kosovë, me një pagë mujore prej 500 eurosh. Por, siç tregon ai, punëdhënësi nuk e ka paguar me rregull, i ka kërkuar të punojë përtej orarit dhe shpesh pa ditë pushimi - çfarë e ka detyruar ta lërë punën.

Nga viti 2018 thotë se ka emigruar në Gjermani me vizë pune, ndërsa një vit më vonë ka marrë edhe gruan dhe tre fëmijët. "Këtu [në Gjermani] është gjë e sigurt që pagën e merr me kohë, që ke sigurim shëndetësor... Nuk është e lehtë jeta as këtu, por ka rregulla që respektohen. Edhe këtu duhet të punosh shumë për të jetuar dhe për të pasur standard të mirë", thotë 47-vjeçari.

Sikur të respektoheshin të drejtat e punëtorëve dhe pagat të ishin më të larta, ai thotë se do të kthehej në Kosovë.

Ambasada gjermane në Prishtinë ka bërë me dije për "Radion Evropa e Lirë" se brenda vitit lëshon rreth 5 500 viza pune për aplikimet që bëhen nga qytetarët e Kosovës.

Ligji i Punës në Kosovë parasheh 40 orë pune në javë, kontratë pune, pushim vjetor me pagesë e të tjera.

Punëdhënësi më i madh në Kosovë është sektori privat, me më shumë se 220 mijë të punësuar. Paga mesatare bruto në këtë sektor është rreth 380 euro.

Në sektorin publik janë të punësuar mbi 80 mijë persona, ndërsa paga mesatare bruto atje është rreth 620 euro.

Nga sektori publik nuk raportohen probleme me mosrespektimin e Ligjit të Punës, as me mungesë punëtorësh.

Bujqësia, gastronomia, ndërtimtaria dhe tregtia raportojnë më së shumti vështirësi në gjetjen e punëtorëve. Sipas Agjencisë së Statistikave (ASK), papunësia në Kosovë është mbi 25 për qind. Të dhënat e fundit të ASK-së për tregun e punës tregojnë se nga mbi një milion qytetarë në moshë pune në Kosovë, mbi 350 mijë janë të punësuar, ndërsa mbi 120 mijë janë të papunë. Sipas ASK-së, rreth 750 mijë qytetarë janë ekonomisht joaktivë, që do të thotë se nuk janë të punësuar, as të regjistruar si të papunë dhe as nuk kërkojnë punë.

Si ndikon mungesa e punëtorëve në ekonomi?

Mungesa e punëtorëve do të bëhet një nga pengesat

kryesore të rritjes ekonomike në Kosovë, thotë drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Prishtinë, Arian Zeka. "Trendi pozitiv i rritjes ekonomike që kemi parë gjatë disa viteve - përjashto vitin 2020 [pandemia Covid-19] - nuk do të arrihet dhe kjo për shkak të mungesës së fuqisë punëtorë", thotë Zeka.

Për ta zbutur problemin, ai thotë se duhet të bëhen përpjekje nga të gjithë - duke filluar nga institucionet deri te punëdhënësit, të cilët duhet ta shqyrtojnë, para së gjithash, nivelin e pagave.

Zeka thotë se mosadresimi i kësaj problematike nga Qeveria e Kosovës është shqetësues.

REL ka kontaktuar disa herë kabinetin e kryeministrit të Kosovës në lidhje me këtë çështje por, deri në publikimin e këtij teksti, nuk ka marrë përgjigje.

Shpëtim Kalludra, udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin e Masave Aktive të Tregut të Punës dhe Analiza pranë Agjencisë së Punësimit, thotë se punëtorë ka - mbi 60 mijë punëkërkuar janë të regjistruar. "Kur numri i punëkërkuarve në Agjencinë e Punësimit të bjerë në 10 mijë, atëherë mund të themi se punëdhënësit kanë të drejtë", thotë Kalludra.

"Radio Evropa e Lirë" ka biseduar me një punonjës në Kosovë, bartës i një familjeje gjashtanëtarëshe, që thotë se paguhet 180 euro në muaj.

J. D., emri i plotë i të cilit

është i njohur për redaksinë, thotë se punon në një kompani private pastrimi. "Këtu ku punoj orari i punës respektohet, edhe ditët e pushimit, edhe kemi kontrata, por paga është e ulët. Në këtë kompani punoj që 10 vjet. Në fillim pagën e kam pasur 130 euro, tani e kam 180 euro", thotë ai.

Me shumë të ngjashme në Kosovë, sipas një studimi të bërë nga Instituti për Hulumtime të Avancuara GAP, paguhen rreth 105 mijë punonjës. Ata kryesisht punojnë në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, në industrinë përpunuese, në gastronomi, në aktivitetet financiare dhe të sigurimit, në ndërtimtarë etj. Kuvendi i Kosovës, më 14 qershor, ka votuar në parim një projektligj, që hap rrugë për rritjen e pagës minimale, nga 130-170 euro sa është aktualisht, në 264 euro bruto, apo 250 euro neto. Sindikatat e punëtorëve janë ankuar edhe për këtë rritje që pritet, duke thënë se nuk u përgjigjet nevojave të qytetarëve.

Kosova, si shumë vende të botës, po përballet me rritje të inflacionit, që ka nisur me pandeminë Covid-19 dhe ka marrë hov pas shpërthimit të luftës në Ukrainë. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, norma e inflacionit në muajin maj është rritur për 12.5 për qind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Diskutohet për digjitalizimin e ATK-së

PRISHTINË, 30 QERSHOR (ER) - Oda Amerikane në bashkëpunim me Programin e USAID-it për Qeverisje Ekonomike në Kosovë ka mbajtur ngjarjen mbi "Digjitalizimin e

Administratës Tatimore të Kosovës: Diskutim me drejtorin e përgjithshëm të ATK-së", në të cilën janë diskutuar të arriturat e deritanishme të Administratës Tatimore të

Kosovës në digjitalizimin, automatizimin dhe përmirësimin e shërbimeve të tatimpaguesve si dhe hapat e ardhshëm në agjendën e digjitalizimit të ATK-së.



Bota po digjet, ndaj është koha për një revolucion të burimeve të rinovueshme



Nga Antonio GUTERRES
"The Independent"

Neroni u akuzua dikur se i binte harpës në kohën që Roma po digjej. Sot, disa udhëheqës po sillen akoma më keq. Ata po i hedhin benzinë zjarrit. Ndërsa pasojat e pushtimit rus të Ukrainës po ndihen anembanë globit, reagimi e disa vendeve ndaj krizës energjetike në rritje ka qenë dyfishimi i përdorimit të karburanteve fosile, duke harxhuar miliarda dollarë më shumë për qymyrin, naftën dhe gazin, të cilat po e thellojnë më tej emergjencën e klimës.

Ndërkohë, të gjithë treguesit e klimës vazhdojnë që të thyejnë rekorde, duke parashikuar një të ardhme me stuhi të jashtëzakonshme, përmbytje, thatësira, zjarre dhe temperatura ekstreme në pjesë të mëdha të botës, të cilat e pamundësojnë jetën normale për njeriun dhe gjallesat e tjera. Bota jonë përballet me një kaos klimatik. Financimi i ri mbi infrastrukturën e kërkimit dhe prodhimit të lëndëve djegëse fosile është një iluzion. Lëndët djegëse fosile nuk janë zgjidhja, dhe as nuk do të jetë ndonjëherë. Ne mund ta shohim që tani efektet e dëmeve që po i shkaktojmë planetit dhe shoqërive tona. Ai shfaqet çdo ditë në lajme, dhe askush nuk është imun. Lëndët djegëse fosile, janë shkaku i krizës klimatike. Energjia e rinovueshme është përgjigja e duhur, për të kufizuar ndryshimin e klimës dhe rritur sigurinë energjetike.

Në rast se do të kishim investuar më herët dhe mëmasivisht në energjinë e rinovueshme, nuk do të gjendeshim sërish në mëshirën e tregjeve të paqëndrueshme të karburanteve fosile.

Burimet e rinovueshme, janë plani i paqes i shekullit XXI-të. Por beteja për një tranzicion energjetik të shpejtë dhe të drejtë, nuk po zhvillohet në një fushë të barabartë. Investitorët po mbështesin ende lëndët djegëse fosile, ndërsa qeveritë japin akoma miliarda subvencione për qymyrin, naftën dhe gazin, rreth 11 milionë dollarë çdo minutë.

Ekziston një term për të favorizuar mjetet komode afatshkurtra mbi mirëqenien afatgjatë: varësia. Ne jemi ende të varur nga lëndët djegëse fosile. Por për hir të shëndetit të shoqërive dhe planetit tonë, ne duhet të heqim dorë nga ato. Dhe duhet ta bëjmë këtë tani.

E vetmja rrugë e vërtetë drejt sigurisë energjetike, çmimeve të qëndrueshme të saj, zhvillimit dhe një planeti të jetueshëm, qëndron tek braktisja e karburanteve fosile ndotëse dhe përsheptimi i tranzicionit energjetik, bazuar tek burimet e rinovueshme.

Për këtë qëllim, unë u kam bërë thirrje qeverive të vendeve të G20-ës që të çmontojnë infrastrukturën e qymyrit, me një ndërprerje të plotë të saj deri në vitin 2030 për vendet e OECD, dhe deri në vitin 2040 për të gjithë të tjerat. Unë u kam kërkuar aktorëve financiarë të braktisin financimin e karburanteve

fosile, dhe të investojnë në energjinë e rinovueshme. Dhe kam propozuar një plan me 5 pika për të nxitur energjinë e rinovueshme në mbarë botën. Së pari, ne duhet ta bëjmë teknologjinë e energjisë së rinovueshme një të mirë publike globale, duke përfshirë heqjen e barrierave të pronësisë intelektuale për transferimin e teknologjisë.

Së dyti, duhet të përmirësojmë qasjen globale tek zinxhirët e furnizimit për komponentët dhe lëndët e para të teknologjive të energjisë së rinovueshme. Në vitin 2020, bota instaloi 5 gigavat magazinim energjie. Ne kemi nevojë për 600 gigavat kapacitet magazinimi deri në vitin 2030.

Është e qartë se për ta përmbushur këtë synim, kemi nevojë për një koalicion global. Linjat problematike të transportit, kufizimet e zinxhirit të furnizimeve, dhe kostot më të larta për litiumin dhe metalet e tjera të baterive, po dëmtojnë vendosjen e teknologjive dhe materialeve të tilla.

Së treti, duhet të reduktojmë procedurat burokratike që pengojnë projektet diellore dhe ato të erës. Ne kemi nevojë për miratime të shpejta të tyre, dhe për më shumë përpjekje për të modernizuar rrjetet e energjisë elektrike. Aktualisht në Bashkimin Evropian duhen 8 vjet për të miratuar ndërtimin e një parku eolik, ndërsa në SHBA 10 vite. Në Korenë e Jugut, projektet generatorëve të erës kërkojnë 22 leje nga 8 ministri të ndryshme.

Së katërti, bota duhet të

zhvendosë subvencionet e energjisë nga lëndët djegëse fosile për të mbrojtur njerëzit më të varfër nga krizat energjetike tek një tranzicion drejt të ardhmeve të qëndrueshme.

Dhe së pesti, ne duhet të 3-fishojmë investimet tek burimet e rinovueshme. Këtu përfshihen bankat e zhvillimit shumëpalësh dhe institucionet financiare të zhvillimit, si dhe bankat tregtare. Të gjithë duhet të rritin në mënyrë të ndjeshme investimet mbi burimet e rinovueshme.

Ne kemi nevojë për më shumë ndjenjë emergjence nga të gjithë liderët globalë. Tashmë ndodhemi rrezikshëm pranë arritjes së kufirit prej 1.5°C, që shkenca na thotë se është niveli maksimal i ngrohjes, për të shmangur ndikimet më të këqija klimatike. Por për qëndruar brenda këtij kufiri maksimal, ne duhet të reduktojmë me 45 për qind emetimet deri në vitin 2030, dhe t'i zerojmë ato deri në mesin e këtij shekulli.

Por angazhimet aktuale në nivel kombëtar, do të çojnë në një rritje prej gati 14 për qind të emetimeve këtë dekadë. Kjo parashikon katastrofën. Përgjigja ndaj kësaj sfide qëndron te burimet e rinovueshme, si për veprimin ndaj krizës së klimës, për sigurinë e energjisë, ashtu edhe për sigurimin e energjisë elektrike të pastër për qindra miliona njerëz që aktualisht u mungon.

Burimet e rinovueshme janë një fitore e trefishtë. S'ka asnjë justifikim për askënd që të refuzojë një revolucion të

këtyre burimeve. Ndërsa çmimet e naftës dhe gazit kanë arritur nivele rekord çmimesh, burimet e rinovueshme po bëhen gjithnjë e më të lira.

Kostoja e energjisë diellore dhe e baterive, ka rënë me 85 për qind gjatë dekadës së fundit. Ajo e energjisë së erës ra me 55 për qind. Dhe investimet në burimet e rinovueshme, krijojnë 3 herë më shumë vende pune sesa lëndët djegëse fosile. Sigurisht, burimet e rinovueshme nuk janë e vetmja përgjigje ndaj krizës së klimës.

Zgjidhjet e bazuara tek natyra, si riparimi i dëmeve nga shpyllëzimi dhe degradimi i tokës, janë thelbësore. Të tilla janë edhe përpjekjet për të promovuar eficientë e energjisë. Por ambicia jonë duhet të jetë një tranzicion i shpejtë i energjisë së rinovueshme.

Ndërsa po heqim dorë nga karburantet fosile, përfitimet do të jenë të mëdha, dhe jo vetëm për klimën. Çmimet e energjisë do të jenë më të ulëta dhe më të parashikueshme, me efekte pozitive për ushqimin dhe sigurinë ekonomike.

Kur rriten çmimet e energjisë, rriten edhe kostot e ushqimit dhe të gjitha mallrave ku mbështetemi. Prandaj le të biem dakord që të gjithë, se një revolucion i shpejtë i burimeve të rinovueshme është i nevojshëm, dhe të ndalojmë së "luajti në harpë", në një kohë që po digjet e ardhmja jonë.

Shënim: Antonio Guterres,
Sekretar i Përgjithshëm i
Organizatës së Kombeve të
Bashkuara.



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Laura Fazliu dhe Akil Gjakova ia sjellin Kosovës edhe dy medalje

Sporti i xhudos deri tash ia ka sjellë Kosovës katër medalje nga Lojërat Mesdhetare "Oran 2022". Të enjten medaljen e artë e fitoi Laura Fazliu, kurse të bronztën Akil Gjakova. Një ditë më parë medaljen e artë e kishte fituar Distria Krasniqi, ndërsa të bronztën Flaka Loxha



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Sporti i Kosovës e ka regjistruar suksesin e radhës në Lojërat Mesdhetare "Oran 2022" pasi të enjten ka fituar dy medalje me sportin e xhudos. Laura Fazliu e ka fituar medaljen e artë, pasi në finale e ka mposhtur spanjollen Perez Cabana (-63 kg) me një waza-ari në Golden Score. Laura e mposhti në gjysmëfinale Amina Belkadin nga Algjeria, kurse në çerekfinale e mposhti Iva Oberanin nga Kroacia. Medaljen e dytë të enjten dhe të katërtën në Lojërat Mesdhetare,

Kosovës ia solli xhudisti Akil Gjakova, i cili e fitoi të bronztë, pasi e mposhti në finale xhudistin italian Manuel Lombardo (-73kg). Akili në çerekfinale triumfoi ndaj grekut Michail Tsoutlasvili për t'u mposhtur në gjysmëfinale nga xhudisti algjerian Dris. Të mërkurën medaljen e artë në lojërat që po zhvillohen në Algjeri, Kosovës ia siguroi Distria Krasniqi, derisa të bronztën e fitoi xhudistja tjetër Flaka Loxha.

I pasuksesshëm të enjten ishte xhudisti i ri Arbër Kullashi, i cili u ndal nga algjeriani Imad Benazoug në raundin e parë, kategoria -81 kg. Kullashi nuk pati fat për ta vazhduar garën në repasazh.

Të enjten garat i kanë nisur edhe shenjëtarët e Kosovës. Drilon Ibrahim garoi në disiplinën 10 metra pushkë ajrore, ku doli i 21-ti me 605 pikë, të cilat nuk i mjaftuan që të hyjë në finale. Sot (e premte) do të garojë shenjëtari tjetër Nexhat Sahiti, i cili garon në disiplinën 10 metra pistoletë ajrore. Ndërsa dy shigjetarët Valmir Gllareva dhe Edi Dvorani janë ndalur në 1/16 e finales në Lojërat Mesdhetare Oran 2022. Të dy ishin të pafat, pasi humbën përballjet e tyre në rrethin e fundit të gjuajtjeve, me rezultat 6:4. Gllareva u përballë me Alesandro Paolin, ndërsa Dvorani me francezin Iban Bariteaud, disiplina hark olimpik.

SHKURT

Më 1 korrik fillon afati kalimtar në hendboll

Më 1 korrik fillon afati i rregullt kalimtar në hendbollin e Kosovës. Afati do të jetë i hapur deri më 15 korrik. Pritet një afat i pasur kalimtar, me lëvizje të shumta të lojtarëve. Tashmë klubet kanë njoftuar për lëvizje të bëra, ndërsa ato do t'i zyrtarizojnë gjatë afatit kalimtar. Kastrioti i Ferizajt ishte prej klubeve më aktive deri më tani, ndërsa lëvizje të hendbollistët do të bëjnë edhe skuadrat e tjera të Superligës. Madje pritet që skuadrat të angazhojnë edhe lojtarë të huaj. Lëvizje pritët të ketë edhe të hendbollistët. Disa skuadra e kanë paralajmëruar këtë.

Marku meçin e radhës e zhvillon në 'Air Albania'

Tashmë është zyrtarë. Boksieri shqiptar Florian Marku luftën e radhës do ta bëjë në stadiumin "Air Albania". Marku ka thënë se për detajet e tjera do të tregojë të shtunën. "Përshëndetje të gjithë shqiptarëve kudo që janë nëpër botë! Dua t'ju lajmëroj se ndeshja në stadiumin 'Air Albania' për këtë verë është vendosur. Të shtunën ju tregoj datën dhe çdo detaj tjetër. Qëkur kam qenë fëmijë ëndrra ime ka qenë të ndeshem në mes të Shqipërisë para jush. Mezi pres!", ka thënë Marku.

Getafe dhe Watfordi në garë për Manajn

Vazhdon të jetë e paqartë e ardhmja e sulmuesit të Kombëtares së Shqipërisë, Rey Manaj. Gazetari italian Gianluca Di Marzio ka raportuar se Manaj pritët të përfundojë te Getafe, por interesim për sulmuesin ka shfaqur edhe skuadra e Watfordit. Sezonin e kaluar Manaj veshi fanellën e Spezias në Serinë A, në formë huazimi, ku regjistroi 29 ndeshje në Serinë A dhe shënoi 5 gola.

Endrit Baholli: Privilegj për mua ta bart fanellën e Prishtinës

PRISHTINË, 30 QERSHOR - FC Prishtina ka njoftuar se ka nënshkruar kontratë trevjeçare me futbollistin e talentuar Endrit Baholli. 22-vjeçari vjen si lojtar me shumë potencial nga skuadra tjetër e kryeqytetit, 2 Korriku. Baholli luan si mesfushor ofansiv dhe gjatë gjithë karrierës është

aktivizuar për 2 Korrikun, duke treguar potencial dhe formë të lartë, me ç'rast ka qenë pjesë edhe e grupmohave të reja të Përfaqësueses së Kosovës. "Besoj se për secilin futbollist krenaria më e madhe është që të luaj për ekipin e vendlindjes. Prishtina ka qenë

gjithmonë synim për mua dhe ky vit ishte vendimtar për transferimin tim në këtë klub. Prishtina e ka një histori të madhe, fanella 'bardhekaltër' duhet përfaqësuar denjësisht andaj është privilegj për mua që të bart këtë fanellë me shumë peshë", ka thënë Baholli.



Marquez: Kisha frikë se nuk do të garoja më pas operacionit

MADRID, 30 QERSHOR - Pasi publikoi fotot që tregojnë shenjat e mbetura në shpatull pas operacionit të katërt në krah për dy vjet, piloti spanjoll i Hondas, Marc Marquez, ka rrëfyer se kishte frikë se mos nuk do të garonte më. "Tani

ndihem shumë më mirë, pasi nuk kam më dhimbje", ka thënë Marquez, tetë herë kampion bote në garat e motoçiklizmit. "Ende nuk e lëviz krahun, pasi e mbaj me mbrojtëse, por jam duke bërë ushtrime. Jam i motivuar dhe kam një ndjesi të

mirë, që më bën entuziast për të ardhmen. Ky operacion i fundit në Amerikë më riktheu shpresat se mund të garoj sërish për titull", është shprehur Marc Marquez. "Për një moment pata frikë se nuk do të garoja më dhe isha në humor të

keq. Kam qenë keq 2-3 ditë para operacionit. Gjithsesi, tani jam më mirë, planifikoj çdo ditë dhe mundohem të jem në formë kur të rinis të garoj. Synoj ta mposht frikën me punë dhe me dëshirë për t'u rikthyer kampion", ka shtuar Marquez.



Kapitenia Demaj: Nuk do të jetë lehtë, por shpresoj se ia dalim

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Për ndeshjet me Ishujt Faroe ka folur edhe kapitenia e Përfaqësueses së Kosovës, Leonora Demaj. Demaj për kohë të gjatë luan në Danimarkë, me shumë sukses, dhe i njezh zhvillimet rreth hendbollit në Ishujt Faroe. Kosova luan me Ishujt Faroe në fazën e parë kualifikuese për Botërorin 2023. Ndeshjet luhen në nëntor. Ndeshja e kthimit është në Kosovë dhe kjo, sipas kapitenes sonë, është përparësi. Demaj për shkak të një lëndimi nuk ka luajtur gjatë për Kosovën, që nga viti 2019. Ajo do të kthehet në ndeshjet e nëntorit. Me të në përbërje, Kosova pritet të jetë dukshëm më e fortë. "Ishujt Faroe kanë përparuar shumë në vitet e fundit. E ka lojën e shpejtë dhe fizikisht lojtaret e Ishujve Faroe janë të



forta. I kanë disa lojtare shumë të mira që treguan lojëra të mira kundër Danimarkës së fundi. Shpresoj të jemi komplet dhe të mos kemi

lëndime të tjera. Shpresoj që si vendase në Prishtinë t'i mposhtim. Nuk është lehtë, por shpresoj t'ia dalim", ka thënë Demaj.

Hajdari: Lojtaret e Ishujve Faroe luajnë shpejt

PRISHTINË, 30 QERSHOR - Qendra e Kombëtares së Kosovës, Marigona Hajdari, po bën karrierë shumë të suksesshme në elitën e Danimarkës. Dhe ajo e di nivelin që ka Kombëtarja e Ishujve Faroe, me të cilën Kosova luan në fazën e parë kualifikuese për Botërorin e vitit të ardhshëm. Ndikimi i hendbollit danez në atë të Ishujve Faroe është shumë i madh. Disa prej lojtareve të Ishujve Faroe luajnë në skuadrat daneze. "Besoj se ndeshjet kundër Ishujve Faroe do të jenë të vështira. Ishujt Faroe kanë luajtur mirë dhe i ka befusuar Danimarkën dhe Rumaninë me lojën dhe shpejtësinë që ka. Mirëpo besoj dhe shpresoj që Kosova me ekip të kompletuar dhe me lojtare 100 për qind në formë, e mposhtë ekipin e Ishujve Faroe", ka thënë Marigona Hajdari. Ndeshjet me Ishujt Faroe luhen në nëntor, ndërsa Marigona



pritet të jetë prej lojtareve kryesore. Ajo ka kohë që po shfaq stabilitet dhe formë të lartë në ligën daneze. Dallohet për organizimin e lojës, por edhe për

shpejtësinë që ka. Te Kombëtarja e Ishujve Faroe e njohin shumë mirë Marigonën. Selektori i saj e kishte ftuar në ekipin që drejtonte disa vjet më parë.

SHKURT

Mercedes: Do të ishte më mirë për Formula 1 sikur Ferrari ta udhëhiqte botërorin

Gjashtë fitore në gjashtë garat e fundit, shtatë në nëntë garat e para sezonale, tregojnë se ky sezon po dominohet nga Red Bull. Ferrari e nisi më mirë sezonin, duke fituar dy nga tri garat e para, por më tej erdhi përmbysja e madhe e makinës austriake. Toto Wolff, shef i Mercedesit, shprehet se është në të mirë të këtij sporti që Ferrari ta përmbysë situatën për ta rihapur garën. "Do të ishte bukur sikur Leclerc ta udhëhiqte botërorin. Do të ishte mirë për Formula 1", ka thënë Wolff. "Ferrari nuk i shfrytëzoi mundësitë që pati dhe humbi disi shkëlqimin që kishte në garat e para. Do të ishte më bukur sikur kampionati të ishte i ekuilibruar deri në garën e fundit. Nëse do të mbyllej çdo gjë që në shtator, do të ishte një gabim për sportin tonë", ka shtuar Wolff.

Juve konfirmon largimin e tre futbollistëve

Skuadra e Juventusit ka konfirmuar largimin e tre futbollistëve. Bëhet fjalë për Paulo Dybalan, Federico Bernardeschin dhe Alvaro Moratan. Marrëveshjet e Dybalas dhe Bernardeschin në Torino përfundojnë sot, ndërsa Morata largohet në fund të një huazimi dyvjeçar. Ai kthehet në Atletico Madrid, ku kontrata e tij skadon verën e ardhshme. Juventus kishte një opsion për ta bërë lëvizjen e tij të përhershme për 35 milionë euro, por vendosi të mos e aktivizonte atë.

'Spurs' ofron 115 milionë euro për dy vjet e Evertonit

Tottenham Hotspur është gati të bëjë një tjetër ofertë për Richarlison të cilin e ka kthyer në një nga objektivat e kësaj vere. Skuadra e Evertonit refuzoi ofertën e parë që ishte 23 milionë euro plus kartonin e Steven Bergwijn. Sipas "The Sun", Tottenhami është gati që të bëjë një mega-operacion për shifrën e 115 milionë euro teksa kërkon kartonin e Richarlison dhe të talentit Anthony Gordon. Në këto shifra, Evertoni vështirë se këtë herë do të thotë jo. Antonio Conte me shumë mundësi do të ketë dy lojtarë të rinj në dispozicion.

Griezmann edhe një vit në Atletico

Sulmuesi Antoine Griezmann do të luajë për Atletico Madrid sezonin e ardhshëm. Skuadra nga Madridi aktivizoi vitin e dytë të huazimit, siç parashikohej në një klauzolë në kontratën e nënshkruar më 31 gusht të vitit të kaluar. Kështu, futbollisti francez do të jetë "Los Colchoneros" edhe një sezon. Më pas, do të jetë koha për ta paguar opsionin e blerjes prej 40 milionësh. Për këtë, nëse ai luan të paktën 50 % të ndeshjeve zyrtare do të jetë automatike, diçka që duket se do të ndodhë duke parë se ai është i rregullt për Simeonen. Griezmann është kyç në Atletico aktualë dhe kjo reflektohet në këtë vendim, i cili eliminon çdo opsion për kalim në ndonjë klub tjetër.

Ibra heq dorë nga milionat, Milan dashuri pa kushte

Gjithçka gati për rinovimin e Zlatan Ibrahimoviçit. Suedezit i skadon kontrata këtë të enjte në mesnatë, por ky detaj nuk ka asnjë rëndësi pasi mes Ibrës dhe

Milanit është një lidhje shumë e fortë. Suedezi ka hequr dorë nga çdo kërkesë, ndërsa ka pranuar të firmosë një kontratë simbolike, ku bëhet fjalë

vetëm për disa qindra mijëra euro, ndërsa më shumë peshë do të kenë bonuset individuale, të lidhura me paraqitjet dhe golat. Në çdo rast bonuset

do të aplikohen në momentin që Ibra do të zbrisë në fushë. Sulmuesi iu nënshtrua një operacioni në gju më 25 mars, ndërsa koha e rikuperimit parashikohet

të jetë 7-8 muaj. Objektivi i Ibrës është të rikthehet në fushë pas përfundimit të Botërorit, kërkon të vihet në dispozicion të trajnerit Pioli përpara Krishtlindjeve.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Euro Balkan News” L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b. 811354472 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Euro Balkan News” L.L.C. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nr.b. 811354472 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Euro Balkan News” L.L.C. Prishtinë has come to the decision to quit its business: 811354472 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

**REPUBLIKA E KOSOVËS
GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS**

C. nr: 1607/22
Data: 21.06.2022
Mitrovicë

**PËR “GAZETEN ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS”
Prishtinë**

Me këtë ju jeni të detyruar të që në një nga botimet tuaja të ardhshme të publikoni shpalljen me përmbajtjen vijuese
“Gjykata Themelore e Mitrovicës, gjyqtarja Sladjana Pajović, në kuptim të nenit 83, të Ligjit për procedurë civile, njofton si në vijim:

SHPLLJE

Gjykata Themelore e Mitrovicës në bazë të vendimit C.nr:1607/22, të datës 20.06.2022, cakton përfaqësues të përkohshme, avokaten Shkelqesa Musa nga Mitrovica, rr. “Bedri Gjinaj,n.n, për të pandehurën Mihaela Petrovici, nga Arad, Rumani. , me adresë aktualisht të panjohur, në lëndën juridike të paditësit Bujar Xhafa, nga fshati Bare, komuna e Mitrovicës, për shkak të zgjidhjes së martesës, përfaqësuar nga Valon Mehmeti, avokat nga Mitrovica.

Përfaqësuesi i përkohshëm do të kryejë detyrat e përfaqësimit të të paditurit gjatë gjithë kohëzgjatjes së procedurës paditore, deri në momentin kur i padituri ose autorizuesi i saj, i zgjedhur prej saj, paraqitet në gjykatë, ose derisa kujdestari të njoftojë gjykatën për kujdestarinë e caktuar për të paditurit. .

Shpenzimet e procedurës sipas nenit 81.2 të Ligjit për procedurë civile i mbulon i pandehuri.

Gjyqtari
Sladjana Pajović (nënshkruar)

Konstatohet se dokumenti i përkyer është identik në kuptim dhe stil me origjinalin, Zejnepe Haxhimetmeti – Përkthyes Gjyqësore



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPLLJE TË VOGLA <<

- ▶ Kemal Ramizagic shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.
- ▶ Jasin Vermica shpall te pavlefshme dëftesën e kl. X. Q.K " 11 Marsi " Prizren.
- ▶ Ermal Begu shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e SHMLM " Xheladin Deda".
- ▶ Mirlinda Gerguri shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHMLM " Dr Xheladin Deda".
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



KOMPANIA REJIONALE E MBETURINAVE
REGIONALNA WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA
K.R.M. "ÇABRATI"

Tel. +381(0)390/321 588
+381(0)390/324 034
www.cabrati.com
e-mail: info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakovë

Në bazë të nenit 17.1 dhe 17.2 dhe nenit 21 të "Ligjit për Ndërmarrje Publike" (Ligji Nr. 03/L-087) i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, Bordi i Drejtorëve i NPL-e Kompanisë Regjionale Mbeturinave "Çabrati" SH.A. Gjakovë në mbledhjen e mbajtur me datë 27.06.2022 me Vendimin Nr. Protokollit 1187, vendosi që me datë 01.07.2022 të shpall ketë:

KONKURS

Pozita e punës: Këshilltar-e i/e Përgjithshëm-e/ Sekretar/e Korporativ/e
Mandati: 3 /tre/ vjeçar

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Mbikëqyrë punët e Sektorit Administrativ;
- Merrë pjesë në krijimin e politikës afariste nga lëmia e Sektorit Administrativ;
- Koordinon punët me shërbimet tjera në kuadër të Kompanisë;
- Përpilon plane mujore dhe vjetore të punëve dhe detyrave të shërbimit;
- Merrë pjesë në punën e Menaxhmentit;
- Jepë këshilla juridike punëtorëve të Kompanisë;
- Bënë interpretimin dhe sqarimin e dispozitave e akteve normative dhe ligjeve tjera në fuqi lidhur me realizimin e administrimit;
- Mirëmbanë regjistrin e aksionarëve;
- Të veprojë si agjent i kompanisë për pranimin e njoftimeve;
- T'i bëjë të gjitha skedimet, publikimet dhe/ose shpalosjet e nevojshme te autoritetet e duhura ashtu siç mund të kërkohet me ligj dhe me statut;
- Të mbikëqyrë mirëmbajtjen e duhur dhe azhurnimin e rregullt të uebsajtit;
- Të koordinohet me Kryeshefin Ekzekutiv në përgatitjen e dokumenteve për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;
- Do të mbajë procesverbalin e çdo mbledhjeje të Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit (nëse nuk është udhëzuar ndryshe nga kryetari i tyre) dhe t'i regjistrojë ato në librin e procesverbalit;
- Si dhe detyrat tjera të cilat (më tutje) mund të jenë të përshkruara në përshkrimin e bashkangjitur të punës ose të caktuara nga punëdhënësi;

Kushtet e përgjithshme:

- Të posedoj përgatitje superiore Fakultetin Juridik, 4 vjeçar, apo me Sistemin e Bolonjes 3+2,
- Të posedoj përvojë pune së paku 5 vite në profesion.

Kushtet e vecanta:

- të ketë integritet të lartë moral e profesional.
- gradimet tjera profesionale do të kenë prioritet.
- të ketë aftësi organizative.
- njohuri të punës me kompjuter.
- njohja e gjuhëve të huaja është përparësi.
- të ketë shkathtësi në të shkruar dhe aftësi komunikimi në të folur.
- të mos jetë i/e dënuar ose nën hetime.

Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim, ndërsa NP mban të drejtën e formimit të listës së shkurtër me aplikant.

Lartësia e pagesë për pozitën e shpallur do të caktohet në harmoni me politikën e NP.

Procedura e aplikimit:

Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia), Diploma e fakultetit- kopje; Dëshmi mbi përvojën e punës; Certifikatat mbi kualifikimet dhe trajnimet-gradimet (do të kenë prioritet); Dëshmia e njohjes së punës me kompjuter, Dëshmia e njohjes së gjuhëve të huaja (përparësi); Kopja e letër njoftimit, Letër motivimi, dhe Deklarata nën betim mbi plotësimin e kushteve e kualifikimit sipas Nenit 17.1 (ii) dhe ka plotësuar kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), dhe (k) (i) dhe (iii) Ligjit për ndërmarrjet Publike, si dhe Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj.

Kandidatet e interesuar për punësim mund të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në Zyrat e KRM. "Çabrati" SH.A. Gjakovë, Rr. "Mazllom Lakuci" Pn. 50000 Gjakovë, në "ZARF TË MBYLLUR" me mbishkrim " Për BORDIN E DREJTORVE TË KRM. "ÇABRATI" SH.A. Gjakovë" dhe Emrin e Mbiemrin dhe gjeneralët e aplikuesit. Afati i fundit për aplikim është 30 ditë nga dita e publikimit, përfundimisht deri me deri me 30.07.2022 në orën 16:00.



KOMPANIA REJIONALE E MBETURINAVE
REGIONALNA WASTE COMPANY
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA
K.R.M. "ÇABRATI"

Tel. +381(0)390/321 588
+381(0)390/324 034
+381(0)390 32 55 55
www.cabrati.com
e-mail: info@cabrati.com
Gjakovë - Gjakovë

Na osnovu člana 17.1 i 17.2, kao i člana 21 "Zakona o Javnim Preduzećima" (Zakon br. 03/L-087) izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L-111, Upravni Odbor LJP Regionalnog Preduzeća za Uklanjanje Otpada (ka) "Çabrati" D.D. Djakovica, na sastanku održanom dana 27.06.2022 godine, Odlukom sa brojem protokola 1187, doneo je odluku da dana 01.07.2022 godine objavljuje sledeći:

KONKURS

Položaj: Opšti/a savetnik/ca – Saradjujući/a Kooperativni/a Sekretar/ica
Mandati: 3 /tri/ godine

Dužnosti i odgovornosti:

- Upravlja poslovima Upravnog Sektora;
- Učestvuje na stvaranju poslovne politike sa polja Upravnog Sektora;
- Koordinira poslove sa drugim službama u okviru Preduzeća;
- Sastavlja mesečne i godišnje poslovne planove i zadatke službe;
- Učestvuje u radu Rukovodstva (Menadžmenta);
- Daje pravne savete radnicima Preduzeća;
- Interpretira i objašnjava normative odredbe i akta i druge primenjive zakone na snazi u vezi sa ostvarivanjem upravljanja;
- Održava registar akcionara;
- Deluje kao agent preduzeća za primljenje obaveštenja;
- Radi sva unošenja u zapisnik, oglašnja i/ili saopštenja potrebnih kod dotičnih vlasti kao što se može zatražiti (zahtevati) zakonom ili statutom;
- Nadgleda potrebno održavanje i redovnu ažurnost veb-sajta;
- Uskladjuje/Koordinira sa Glavnim Izvršnim Direktorom u pripremanju dokumenata za sednice Upravnog Odbora;
- Održava zapisnik svake sednice Upravnog Odbora i Komisije Revizije (ako nije drugačije propisano/upućeno od njihovog predsednika) i upisuje ih u knjizi zapisnika;
- Kao i druge dužnosti koje (dalje) mogu da budu propisane u priloženom opisu posla ili odredjene od strane poslodavca;

Opšti uslovi:

- Viša stručna sprema Pravni fakultet, 4-oro godišnji, ili prema Bolonjskom Sistemu 3+2;
- Radno iskustvo od najmanje 5 godina u profesiji/struci.

Posebni uslovi:

- visoki moralni i stručni integritet.
- druga unapredjenja imaće prednost.
- organizacione sposobnosti.
- poznavanje rada na računaru.
- poznavanje stranih jezika je prednost.
- veštine u pisanju i veštine komunikacije u govoru.
- da ne bude osudjen/a ili pod istragom.

Formalno vrednovanje (procenjivanje) i intervju biće izvršeni posle isteka roka za prijavljivanje molbi/prijava, dok JP zadržava pravo formiranja uže liste podnosioca molbe/prijava (kandidata).

Visina plate za objavljeni položaj utvrdit će se u skladu sa politikama JP/Javnog Preduzeća.

Postupak podnošenja prijave/molbe (konkurisanja):

Uz prijavu/molbu se prilazu i sledeća dokumenta:

- CV (Životopis/biografija), Diploma fakulteta- kopija; Dokaz o radnom iskustvu; Uverenja o kvalifikacijama i obučavanjima (imaće prednost); Dokaz poznavanja rada na računaru, Dokaz poznavanja stranih jezika (prednost); Kopija lične karte; Motivaciono pismo, i Izjava pod zakletvom o ispunjavanju uslova kvalifikacije prema članu 17.1 (ii) i ispunjavanju kriterija nezavisnosti prema članu 17.2 tačke (d), (f), (k), (i) i (iii) Zakona o javnim Preduzećima, kao i Dokaz da niste pod istragom, ne stariji od 6 meseci.

Zainteresovani kandidati za zapošljavanje mogu da podnesu traženu dokumentaciju u Kancelarijama RPO "Çabrati" D.D., Djakovica, Ul. "Mazllom Lakuci" b.b., 50000 Djakovica, u "zaključenom koveratu" s natpisom "ZA UPRAVNI ODBOR RPO "ÇABRATI" D.D. Djakovica" i imenom i prezimenom i opštim podacima podnosioca prijave/molbe.

Zadnji rok za podnošenje prijave/molbe je 30 dana od dana objavljivanja konkursa, zaključno do dana 30.07.2022 u 16:00 sati.

